



Финансирано од
Европска Унија



ГРАЃАНСКИ
РЕСУРСЕН
ЦЕНТАР



Center for Civil Communications
Центар за граѓански комуникации

Hulumtim mbi projektet infrastrukture nëpër komunat nga programi qeveritar për decentralizim:



“Injektim” me vlerë prej 112 milionë euro nga Qeveria për komunat në vitin e zgjedhjeve lokale

Ky projekt është i financuar nga Bashkimi Evropian, në kuadër të projektit “Shpenzim i drejtë për zgjedhje të drejta: Monitorim i prokurimeve publike të komunave në vitin e zgjedhjeve” i realizuar nga Qendra për Komunikime Qytetare. Ky projekt është nëngrant i fituar në kuadër të “BE përkrahje për Qendrën Qytetare për Resurse – faza 2”, i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e raportit është përgjegjësi vetëm e realizuesit të projektit dhe nuk nënkupton refleksion të qëndrimeve të Bashkimit Evropian dhe të Qendrës Qytetare për Resurse.

Hulumtim mbi projektet infrastrukture nëpër komunitat nga programi qeveritar për decentralizim:
“Injektim” me vlerë prej 112 milionë euro nga Qeveria për komunitat në vitin e zgjedhjeve lokale

Botuesi: Qendra për Komunikime Qytetare

Përkthimi në gjuhën shqipe: Agon Ismaili

Dizajni grafik: Qendra për Komunikime Qytetare

Botimi elektronik

CIP - Katalogizimi në publikim

Nacionalna i univerzitetaska biblioteka "Св. Климент Охридски", Скопје

352:354.1(497.7)"2024/25"(047)

ИСТРАЖУВАЊЕ за инфраструктурните проекти во општините од владината програма за децентрализација : „инјекција“ од 112 милиони евра од Владата за општините во годината на локалните избори [електронски извор] = Hulumtim mbi projektet infrastrukture nëpër komunitat nga programi qeveritar për decentralizim: : “injektim” me vlerë prej 112 milionë euro nga Qeveria për komunitat në vitin e zgjedhjeve locale = Research of infrastructure projects in municipalities from the Government's decentralization program: : "injection" of €112 million from the Government for municipalities in the year of local elections. - Текст во ПДФ формат, содрж. [29] стр., илустр.

Начин на пристапување (URL):

<https://www.ccc.org.mk/injekcija-od-112-milioni-evra-od-vladata-za-opshtinite-vo-godinata-na-lokalnite-izbori/>.

- Фусноти кон текстот. - Наслов преземен од екран. - Опис на изворот на ден 13.02.2026 година. - Напореден текст на македонски, албански и англиски јазик. -

Финансиер: Овој извештај е финансиран од Европската унија во рамки на проектот „Фер трошење за фер избори: Следење на јавните набавки на општините во изборната година“ спроведуван од Центарот за граѓански комуникации

ISBN 978-608-4974-49-9

а) Локална власт -- Централна власт -- Финанси -- 2024-2025 -- Извештаи

COBISS.MK-ID 68128005

PËRMBAJTJA:

Përmbledhje	2
Gjetjet kryesore nga hulumtimi	3
Përfundime	9

PËRMBLEDHJE

- Vetëm në periudhën nga tetori 2024 deri në tetor të vitit 2025, përkatësisht në vitin e fundit para zgjedhjeve, Qeveria planifikoi 250 milionë euro për projekte infrastrukturore për komunat dhe miratoi 112 milionë euro nga këto fonde, përmes gjashtë ministrive (Ministritë së Transportit, Ministritë së Sportit, Ministritë së Arsimit, Ministritë së Mjedisit, Ministritë së Politikës Sociale dhe Ministritë së Kulturës).
- Vendimin e parë për shpërndarje të mjeteve në vlerë prej 71.1 milion euro Qeveria e miratoi në tetor të vitit 2024, të dedikuara për 288 projekte komunale, të përzgjedhura në një konkurs publik të shpallur më parë. Fonde nga kjo transhë nuk u janë miratuar vetëm tre komunave – Qytetit të Shkupit, Strumicës dhe Sarajit.
- Vendimin e dytë për shpërndarjen e mjeteve në vlerë prej 41.4 milionë euro shtesë për 828 projekte Qeveria e miratoi më 4 korrik 2025, apo për më pak se tre muaj para zgjedhjeve. Të gjitha komunat përveç Qytetit të Shkupit fituan para nga kjo transhë. Nga muaji korrik deri më 9 gusht (dita kur u shpallën zgjedhjet), pothuajse të gjitha komunat kanë bërë rebalancim të buxhetit për t'i përfshirë këto para dhe që të mund t'i zbatojnë projektet pa pengesa në dy muajt e fundit para zgjedhjeve.
- Këshilli Fiskal identifikoi dy faktorë rreziku që kishin të bëjnë me këto projekte: (1) mundësinë që ato të interpretohen si një masë populiste para zgjedhjeve lokale dhe (2) mundësinë që pjesë e madhe e këtyre fondeve të mos realizohen plotësisht ose të mos realizohen në mënyrë efikase për shkak të zgjedhjeve lokale dhe funksionalitetit të paplotë të komunave.
- Edhe pse Qeveria aprovoi projekte me vlerë prej 71 milion euro për vitin 2024, ajo "rezervoi" vetëm 15.5 milionë euro në Buxhetin e vitit 2024, ndërkaq në fakt shpenzoi vetëm 345 mijë euro. Prandaj, këto para u kombinuan me paratë për projekte për vitin pasardhës, përkatësisht viti 2025 dhe në Buxhetin e këtij viti, Qeveria planifikoi 102 milionë euro për këto projekte.
- Menjëherë pas zgjedhjeve, Qeveria bëri reduktime të konsiderueshme të fondeve në buxhetin për këto projekte, dhe së pari, me Vendimin për rishpërndarjen e fondeve në Buxhet, vlera prej 102 milionë euro u reduktua në 44 milionë euro, përkatësisht reduktim për 58 milionë euro. Pastaj, me Buxhetin e ri për vitin 2026, u bë reduktim në fondet që paraprakisht ishin të planifikuara për vitet 2026 dhe 2027, edhe atë si në vijim: për vitin 2026 ishin planifikuar 70 milionë, ndërkaq kjo vlerë është reduktuar në 41 milion, kurse për vitin 2027 ishin planifikuar 77 milionë, vlerë kjo e cila, sipas planit tani është reduktuar në 63 milionë. Sipas kësaj, vlera e parë prej 250 milionë euro, për projektet komunale nga Kredia Hungareze tani është reduktuar në 149 milionë euro.
- Përndryshe, sa i përket secilës komunë veçmas, më së shumti para, përkatësisht më tepër se 5 milionë euro për një komunë janë miratuar për Manastirin (5.6 milionë euro), Tetovën (5.5 milionë euro), Kumanovën (5.3 milionë euro) dhe Aerodromin (5.3 milionë euro), ndërsa afër kësaj vlere është edhe Komunat e Prilepit (4.4 milionë euro).
- Për kokë banori, shumat më të mëdha të parave të miratuara janë për Demir Kapi (99 euro), Zhelinë (82 euro), Sveti Nikole (79 euro), Gradsko (78 euro) dhe Kratovë (76 euro). Më së paku para për kokë banori kanë fituar Qyteti i Shkupit (0 euro), Strumica (16 euro), Saraj (23 euro), Qendra (41 euro) dhe Kërçova (49 euro).
- Një vlerësim i posaçëm për ndikimin e këtyre shpenzimeve mbi përmirësimin e kushteve të jetesës dhe punës së grave, të rinjve dhe grupeve të margjinalizuara tregon se vetëm 11, përkatësisht më pak se 1% nga 1,116 projekte, mund të identifikohen drejtpërdrejt për këto grupe qytetarësh. 9 komuna kanë projekte të këtilla, me vlerë totale prej 4.3 milionë euro, ose 3.8% të vlerës së projekteve të aprovuara. Nga 11 projektet, 10 janë për të rinjtë, 1 për grupet e margjinalizuara dhe asnjë për gratë.

GJETJET KRYESORE NGA HULUMTIMI

Që nga tetori i vitit 2024 e tutje, për komunat Qeveria ka miratuar një total prej 111,662,612 euro për projekte infrastrukturore, nga paratë e të ashtuquajturës kredi hungareze. Paratë u ndanë përmes gjashtë ministrive, varësisht prej llojit të projekteve për të cilat kanë qenë të dedikuara.

Vendimin e parëⁱ Qeveria e miratoi saktë një vit para zgjedhjeve lokale, pra më 16 tetor 2024, për shpërndarjen e 71.1 milion eurove.ⁱⁱ Kjo pjesë e parave ishte e dedikuar për 288 projekte komunale, të përzgjedhura në një konkurs publik të shpallur prej më parë. Vetëm tre njësi të vetëqeverisjes lokale nuk fituan fonde nga kjo transhë e parë, përkatësisht Qyteti i Shkupit, Saraji dhe Strumica.

Ministria	Projektet e miratuara në vitin 2024	Paratë e parapara në buxhetin për vitin 2024	Paratë e shpenzuara nga buxheti në vitin 2024
Transport	2,979,446,146	562,664,000	14,391,666
Mjedis Jetësor	629,263,261	58,852,000	0
Arsim	301,850,066	187,213,656	6,819,844
Çështje Sociale	43,890,000	43,890,000	0
Kulturë	199,460,590	39,893,000	0
Sport	220,064,186	58,070,450	0
Gjithsej (denarë)	4,373,974,249	950,583,106	21,211,510
Gjithsej (euro)	71,121,533	15,456,636	344,903

Vendimin e dytëⁱⁱⁱ Qeveria e miratoi tre muaj e gjysmë para zgjedhjeve lokale, përkatësisht më 1 korrik 2025, për shpërndarjen e fondeve shtesë në vlerë prej 41.4 milionë euro^{iv}. Ky vendim u ndryshua në gusht të vitit 2025 dhe shuma u korrigjua në 40.5 milionë euro^v. Kjo pjesë e fondeve, megjithëse me vlerë dukshëm më të vogël nga vlera e mëparshme, është dedikuar për shumë më tepër projekte, përkatësisht për 828 projekte, të cilat gjithashtu janë përzgjedhur pas një konkurs publik të shpallur paraprakisht. Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale, përveç Qytetit të Shkupit, fituan mjete nga kjo transhë.

Ministria	Projektet e miratuara në vitin 2025	Vlera totale e projekteve të miratuara në vitin 2024 dhe 2025	Paratë e parapara në buxhetin për vitin 2025
Transport	1,621,049,741	4,600,495,887	3,984,000,000
Mjedis Jetësor	165,504,005	794,767,266	778,962,000
Arsim	361,184,998	663,035,064	644,185,000
Çështje Sociale	100,000,000	143,890,000	350,871,000
Kulturë	135,539,410	335,000,000	335,000,000
Sport	109,998,207	330,062,393	183,416,000
Gjithsej (denarë)	2,493,276,361	6,867,250,610	6,276,434,000
Gjithsej (euro)	40,541,079	111,662,612	102,055,837

Në muajin midis miratimit të vendimit të Qeverisë (më 4 korrik 2025) dhe ditës së shpalljes së zgjedhjeve^{vi} (9 gusht 2025), thuajse të gjitha komunat kanë bërë ndryshime në programet e tyre dhe, përkitazi në buxhetet e tyre, me anë të të cilave i kanë përfshirë projektet dhe paratë e alokuara nga Qeveria në mënyrë që ligjërisht të mund ta "mbulonin" shpenzimin e parave në muajt menjëherë para zgjedhjeve.

Me të dyja transhat së bashku, vetëm në vitin 2025, komunave u shpërndahen 111.7 milionë euro.

Ministria	Projektet e miratuara në vitin 2024	Mjetet financiare e parapara në buxhetin për vitin 2024	Mjetet financiare të shpenzuara nga buxheti për vitin 2024	Projektet e miratuara në vitin 2025	Vlera totale e projekteve të miratuara në vitin 2024 dhe 2025	Mjetet financiare e parapara në buxhetin për vitin 2025
Transport	2,979,446,146	562,664,000	14,391,666	1,621,049,741	4,600,495,887	3,984,000,000
Mjedis Jetësor	629,263,261	58,852,000	0	165,504,005	794,767,266	778,962,000
Arsim	301,850,066	187,213,656	6,819,844	361,184,998	663,035,064	644,185,000
Çështje Sociale	43,890,000	43,890,000	0	100,000,000	143,890,000	350,871,000
Kulturë	199,460,590	39,893,000	0	135,539,410	335,000,000	335,000,000
Sport	220,064,186	58,070,450	0	109,998,207	330,062,393	183,416,000
Gjithsej (denarë)	4,373,974,249	950,583,106	21,211,510	2,493,276,361	6,867,250,610	6,276,434,000
Gjithsej (euro)	71,121,533	15,456,636	344,903	40,541,079	111,662,612	102,055,837

Pavarësisht vlerës prej 71 milion euro të miratuar për komunitat në vitin 2024, Qeveria megjithatë "rezervoi" vetëm rreth 15.5 milionë euro në buxhetin për atë vit^{vii}, ndërsa komunitat realisht kanë shpenzuar vetëm një shumë modeste prej 345 mijë euro ose 0.5 % të mjeteve financiare të miratuara për vitin 2024. Së këtejmi, fondet e miratuara për vitin 2024 u kombinuan me fondet për vitin 2025 dhe për to së bashku, në Buxhetin^{viii} për vitin 2025, Qeveria planifikoi 102 milionë euro (edhe pse vlera totale e projekteve të aprovuara për komunitat për këtë periudhë ka qenë 112 milionë euro).

Reduktimet e fondeve për vitin 2025, pas zgjedhjeve


Pas zgjedhjeve lokale, në fillim të dhjetorit 2025, Qeveria përsëri, këtë herë në mënyrë më drastike, i uli fondet për projektet infrastrukturore të komunave për më shumë se gjysmën, përkatësisht për 58,439,026 euro. Konkretisht, me Vendimin për rishpërndarjen e fondeve midis përdoruesve të buxhetit të qeverisë qendrore dhe midis fondeve^{ix}, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë më 5 dhjetor 2025, 102 milionë eurot e planifikuara më parë në Buxhetin qendror për vitin 2025 janë zvogëluar në 43.6 milionë euro.

Ministri	Mjetet financiare të parapara në buxhetin për vitin 2025	Mjetet financiare të reduktuara me Vendimin për Rishpërndarje	Vlera përfundimtare e mjeteve financiare të parapara në Buxhetin e vitit 2025
Transport	3,984,000,000	-2,183,000,071	1.800.999.929
Mjedis Jetësor	778,962,000	-570,000,000	208,962,000
Arsim	644,185,000	-442,000,000	202,185,000
Çështje Sociale	350,871,000	-200,000,000	150,871,000
Kulturë	335,000,000	-179,000,000	156,000,000
Sport	183,416,000	-20,000,000	163,416,000
Totali (denarë)	6,276,434,000	-3,594,000,071	2,682,433,929
Totali (euro)	102,055,837	-58,439,026	43,616,812

Reduktim shtesë të fondeve në Buxhetin e vitit 2026

Në shqyrtimin e nënprogrameve zhvillimore në rishikimin e Buxhetit të vitit 2025, Qeveria fillimisht planifikonte që komunave t'u ndajë edhe 148 milionë euro për këto projekte edhe në dy vitet e ardhshme, pra vitet 2026 dhe 2027. Kjo shumë, së bashku me shumën prej 102 milionë euro të planifikuar fillimisht në Buxhetin e vitit 2025 dhe shumën prej 345 mijë euro të shpenzuara në vitin 2024, duhet të ishte rumbullakim i shumës totale të mjeteve financiare për projektet infrastrukturore të komunave nga kredia hungareze në 250 milionë euro.

Shpërndarja fillimisht e planifikuar e parave për komunat sipas vitit (euro)




Viti	Shuma
2024 (të shpenzuara)	344,903
2025 (në Buxhet)	102,055,837
2026 (plan)	70,180,813
2027 (plan)	77,496,667
Gjithsej	250,078,220

Mirëpo, me buxhetin e vitit 2026^x, në vitin 2025 u bënë reduktime shtesë në këto fonde, kështu që, në vend të dinamikës së zbatimit të planifikuar fillimisht me vlerë prej 70 milionë në vitin 2026, në Buxhetin e vitit 2026, të miratuar më 10 dhjetor 2025, shuma e këtyre fondeve u zvogëlua në 41.5 milionë euro për vitin 2026.

Gjithashtu janë reduktuar fondet e planifikuara për vitin e ardhshëm 2027, nga shuma prej 77.5 milionë euro e planifikuar fillimisht, në 63.3 milionë euro. Me këto rregullime, shuma totale e fondeve për projektet infrastrukturore të komunave, nga 250 milionë euro të planifikuara, është zvogëluar në 149 milionë euro.

Reduktime në fondet për komunat për vitet veçmas (euro)



Mjetet financiare të parapara dhe të planifikuara fillimisht (para zgjedhjeve)	
Viti	Shuma
2024 (të shpenzuara)	344,903
2025 (në Buxhet)	102,055,837
2026 (plan)	70,180,813
2027 (plan)	77,496,667
Totali	250,078,220

Reduktimet e fondeve dhe planet (pas zgjedhjeve)	
Viti	Shuma
2024 (të shpenzuara)	344,903
2025 (shumë e reduktuar)	43,616,812
2026 (plan i reduktuar)	41,465,301
2027 (plan i reduktuar)	63,250,000
Totali:	148,677,016

Katër komuna me mbi 5 milionë euro secila, Qyteti i Shkupit asnjë denar

Kur bëhet fjalë për komunat ndaras, vërehet një shpërndarje joproportionale e fondeve bazuar në numrin e banorëve dhe vlerën. Kështu, katër komunave iu janë miratuar më tepër se pesë milionë euro veçmas: Manastirit (5.6 milionë euro), Tetovës (5.5 milionë euro), Kumanovës (5.3 milionë euro) si dhe Aerodromit (5.3 milionë euro), ndërsa afër këtyre shumave është Prilepi (4.4 milionë euro).

Shumat më të mëdha absolute të parave të miratuara (në euro)	
Manastiri	5,649,517
Tetova	5,500,916
Kumanova	5,341,896
Aeroporti	5,265,190
Prilepi	4,404,991

Sa i përket mjeteve të miratuara për kokë banori, shumat më të mëdha janë për Demir Kapi (99 euro), Zhelinë (82 euro), Sveti Nikole (79 euro), Gradsko (78 euro) dhe Kratovë (76 euro). Më së paku para për kokë banori kanë marrë Qyteti i Shkupit (0 euro), Strumica (16 euro), Saraji (23 euro), Qendra (41 euro) dhe Kërçova (49 euro).

Më së shumti para për kokë banori (në euro)	
Demir Kapi	99
Zhelinë	82
Sveti Nikole	79
Gradsko	78
Kratovë	76

Më së paku para për kokë banori (në euro)	
Qyteti i Shkupit	0
Strumica	16
Saraji	23
Qendra	41
Kërçova	49

Më pak se 1% e projekteve i kanë në fokus të drejtpërdrejt gratë, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara.

Kur bëhet fjalë për vlerësimin e ndikimit të drejtpërdrejtë të projekteve infrastrukturore të miratuara mbi përmirësimin e kushteve për jetesë dhe punë të grave, të rinjve dhe grupeve të marginalizuara, mund të konstatohet se vetëm 11 prej 1116 projekteve, apo më pak se 1%, mund të identifikohen si projekte për këto grupe qytetarësh.

Nga këto 11 projekte, 10 janë për të rinjtë, 1 për grupet e marginalizuara dhe asnjë për gratë.

Vetëm 9 komuna kanë projekte të këtilla, me vlerë totale prej 4.3 milionë euro, ose 3.8% të vlerës së projekteve të miratuara dhe ato janë:

Projektet e identifikuar si projekte me ndikim të drejtpërdrejtë mbi grupet specifike të qytetarëve (në euro)				
Komuna	Të rinjtë	Të marginalizuarit	Gratë	Totali
Tetovë	2,415,287	/	/	2,415,287
Koçani	/	569,106	/	569,106
Kërçovë	435,650	/	/	435,650
Vallandovë	195,122	/	/	195,122
Veles	180,186	/	/	180,186
Gostivar	176,277	/	/	176,277
Demir Hisar	136,527	/	/	136,527
Kavadar	117,852	/	/	117,852
Çair	54,329	/	/	54,329
Totali	3,711,231	569,106	/	4,280,336

Prokurimet publike për zbatimin e projekteve: kompanitë dominuese nëpër komunat ndaras, afatet e shkurta dhe afatet e gjata për pagesë

Për sa u përket prokurimeve publike që komunat i zbatojnë për realizimin e projekteve infrastrukturore të aprovuara nga Qeveria, tenderët e parë u shpallën dhe kontratat u nënshkruan kah fundi i vitit 2024.

Edhe pse tenderët veçmas nuk ishin çështje e kësaj analize, prapëseprapë mund të vërehet se në disa komuna vërehet praktika, kur një numër i vogël i kompanive të njëjta marrin pjesë dhe ato kompani t'i fitojnë tenderët.


Gjithashtu, çështje shqetësuese janë pagesat ndaj kompanive për punën e kryer si pjesë e këtyre projekteve. Konkretisht, për shumë nga tenderët nga transha e parë e projekteve të aprovuara në tetor të vitit 2024, ndërsa të shpallura dhe të ndara deri në fund të vitit të njëjtë ose në fillim të vitit 2025, afati i fundit për realizimin e kontratave ka qenë një vit ose deri në tremujorin e fundit të vitit 2025. Përkundër kësaj, pagesa për punët e kryera është paraparë të bëhet në periudhë prej 3 vitesh, përkatësisht në vitet 2025, 2026 dhe 2027. Për shumë pjesëmarrës në këto procedura, si nga autoritetet kontraktuese ashtu edhe nga operatorët ekonomikë, ishte e paqartë se si do të bëhej pagesa, pra kompanitë t'i mbarojnë punët e tyre dhe të investonin fondet e tyre në vitin 2025, ndërsa për këtë do të paguheshin gjatë një periudhe trevjeçare.

Gjithashtu, duke e pasur parasysh që pagesa për projektet është në periudhë prej tre vite, këto projekte kualifikohen si projekte zhvillimore, megjithëse shumë prej tyre nuk kanë karakteristika tjera të projekteve zhvillimore, përveç periudhës më të gjatë të pagesës. Këto janë projekte për riparimin, rindërtimin ose ndërtimin e rrugëve dhe intervenime të ngjashme lokale infrastrukturore.

Shpenzimet kapitale në buxhetet komunale u zmadhuan me një mesatare prej 92 % në vitin e zgjedhjeve

Paratë për komunat të miratuara nga Qeveria prej kredisë hungareze ishin një “injektim” i konsiderueshëm për komunat në muajt parazgjedhorë. Ato i rritën shumat e investimeve kapitale të komunave në buxhetet e vitit 2025, krahasuar me realizimin për vitin 2024, me një mesatare prej 92 %.

Ato gjithashtu kontribuan për një rritje mesatare prej 36 % të buxheteve komunale në të njëjtin vit 2025 krahasuar me buxhetet e realizuara në vitin e mëparshëm. Projektet gjithashtu i rritën shumat për prokurimet publike të komunave, edhe atë me një mesatare prej 40 % në vitin 2024, krahasuar me vitin paraprak 2023.



Këshilli Fiskal sugjeroi në rrezikun për interpretimin e masës si populiste

Këshilli Fiskal i RMV-së, i cili jep mendim të detyrueshëm mbi buxhetet dhe rebalancet buxhetore, në mendimin e tyre kanë sugjeruar në dy faktorë rreziku në lidhje me këto fonde për komunat, në mendimin e tyre^{xi} nga muaji qershori i vitit 2025 në lidhje me rebalancin e Buxhetit të vitit 2025.

“Grante kapitale të zmadhuara të shpërndara mbi bazë të drejtë, duke u udhëhequr nga parimi i zhvillimit të barabartë rajonal, siç thuhet në vetë rebalancin e buxhetit është një sinjal i mirë, por duhet të mbahet llogari për kapacitetin e komunave për realizimin e këtyre shpenzimeve, si dhe fakti që bëhet fjalë për një vit në të cilin duhet të mbahen zgjedhje lokale, kështu që mund të identifikohen dy faktorë rreziku:

1. grantet e zmadhuara për njësitë lokale të interpretohen si një masë populiste për investime konkrete para zgjedhjeve dhe
2. një situatë tjetër potenciale është që për shkak të zgjedhjeve dhe funksionalitetit të paplotë të komunave, një pjesë e madhe e këtyre fondeve mund të mos realizohen tërësisht ose mund të mos realizohen në mënyrë efikase.

Përveç kësaj, projektimet për grantet kapitale për komunat në vitet 2026 dhe 2027 janë dukshëm më të ulëta se shpenzimet e zmadhuara me rebalancin e buxhetit të vitit 2025.”

Sugjerimet nga vëzhguesit ndërkombëtarë të zgjedhjeve lokale 2025

Përfaqësuesit e misioneve ndërkombëtare që i vëzhguan zgjedhjet lokale, në raportet e tyre pas zgjedhjeve kanë shprehur gjithashtu shqetësime në lidhje me shfrytëzimin e resurseve publike për qëllime zgjedhore. Në raportimet e tyre^{xii}, bazuar në gjetjet dhe konkluzionet preliminare nga monitorimi i zgjedhjeve lokale, ata kanë përmendur se: "raste të caktuara të keqpërdorimit të fondeve publike... ishin shqetësuese" (Mateo Mekaçi, shef i Misionit të OIDHR-së për vëzhgimin e zgjedhjeve); "Dëgjuam shqetësime të përhapura në lidhje me keqpërdorimin e resurseve shtetërore në prag të zgjedhjeve në kontekst të perceptimit shumë të përhapur për korrupsion" (Gobnit Ni Vimnehan, shef i Delegacionit të Kongresit të Këshillit të Evropës); "Pohojmë që disa bashkëbisedues kanë shprehur frikë se ka pasur disa parregullsi, keqpërdorim të mundshëm të resurseve shtetërore..." (Marta Temido, shef i Delegacionit të Parlamentit Evropian).

PËRFUNDIME

- Përfundimi i përgjithshëm është se fondet prej kredisë hungareze, të miratuara nga Qeveria për komunat ishin një "injektim" i konsiderueshëm për komunat në muajt parazgjedhorë, në këtë mënyrë duke i rritur:
 - shumat e shpenzimeve të tyre kapitale në buxhetet për vitin 2025, krahasuar me realizimin për vitin 2024, me mesatare prej deri 92 %;
 - buxhetet për vitin 2025, krahasuar me buxhetet e realizuara për vitin e mëparshëm, me një mesatare prej 37 % dhe
 - prokurimet publike të komunave në vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, me një mesatare prej 40 %.
- Fondet nuk kanë qenë të shpërndara në mënyrë të barabartë midis komunave, as për nga numri i banorëve dhe as për nga vlera e atyre fondeve.
- Shumica e kryetarëve të komunave në mënyrë intensive i promovuan projektet gjatë vitit të zgjedhjeve lokale dhe në periudhën parazgjedhore.
- Projektet u kualifikuan si "zhvillimore", për shkak se financimi i tyre është paraparë të bëhet për një periudhë trevjeçare, megjithëse një pjesë e konsiderueshme e tyre në realitet janë riparime, rindërtime ose ndërtim i rrugëve dhe intervenime të ngjashme lokale infrastrukturore.
- Nuk ka informacion të qartë se si do të paguhen kompanitë gjatë një periudhe trevjeçare dhe për projektet e përfunduara në vitin 2025.
- Në shumicën e shpalljeve për prokurime publike për transhën e parë të projekteve janë paraparë afate të shkurtra për ndërtimin e projekteve, në të shumtën e rasteve deri në tetor të vitit 2025, përkatësisht deri në muajin e zgjedhjeve lokale.
- Në një pjesë të konsiderueshme të komunave të analizuara, vërehet dominimi i një apo disa kompanive që kanë fituar kontrata për prokurime publike për ndërtimin e projekteve.
- Për dallim nga promovimi i intensifikuar i projekteve në fillim, në vitet 2024 dhe 2025, thuhet se nuk ka pasur asnjë njoftim të ngjashëm publik në lidhje me reduktimin e konsiderueshëm të fondeve për projektet pas zgjedhjeve lokale, as ndonjë sqarim për arsyet e reduktimit të mjeteve financiare.

ⁱProcesverballi i mbledhjes së 26-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e mbajtur më 16 tetor 2024, linku:

<https://portal.mdt.gov.mk/post-records/26-ta-sednica-na-vladata-2024-record-mk.pdf>

ⁱⁱVendime për përdorimin e fondeve për grante kapitale për njësitë e vetëqeverisjes lokale për projekte infrastrukturore për vitin 2024, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 215 nga data 21 tetor 2024, linku:

<https://www.slvesnik.com.mk/Issues/95eef5a4dc9b406cb822489418ca51b6.pdf> dhe Vendime për ndryshimin e Vendimit për përdorimin e mjeteve për grante kapitale për njësitë e vetëqeverisjes lokale për projekte infrastrukturore për vitin 2024, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 251 nga data 12 dhjetor 2024, linku:

<https://www.slvesnik.com.mk/Issues/355bf0df3a85478aa85367a41444eaa1.pdf>; Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 252 nga 13 dhjetor 2024, linku: <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/bfac49f92c914e16a2530ef37fa6d32a.pdf> dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 278 nga data 31 dhjetor 2024, linku:

<https://www.slvesnik.com.mk/Issues/95a04cf6d810429c8aaeb1a5768ef99d.pdf>

ⁱⁱⁱProcesverballi i mbledhjes së 88-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e mbajtur më 1 korrik 2025, linku:

<https://portal.mdt.gov.mk/post-records/88-ta-sednica-na-vladata-record-mk.pdf>

^{iv}Vendime për përdorimin e fondeve për grante kapitale për njësitë e vetëqeverisjes lokale për projekte infrastrukturore për vitin 2025, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 135 nga data 4 korrik 2025, linku:

<https://www.slvesnik.com.mk/Issues/1a2c96665aa445bb9aadd2c4ff5b61d0.pdf>

^vVendim për ndryshimin e Vendimit për përdorimin e mjeteve për dotacione kapitale për njësitë e vetëqeverisjes lokale për projekte infrastrukturore në fushën e sportit për vitin 2025, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 165 nga data 7 gusht 2025, linku:

<https://www.slvesnik.com.mk/Issues/eb23298cf23e4339913c402cbd98aa70.pdf>

^{vi}Vendim për shpalljen e zgjedhjeve për anëtarë të këshillave të komunave dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit dhe për kryetarë të komunave dhe për Kryetar të Qytetit të Shkupit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 167 nga data 9 gusht 2025, linku:

<https://www.slvesnik.com.mk/Issues/49f32869a1774e0b809c2c144490c35c.pdf>

^{vii}Llogaria Përfundimtare e Buxhetit të RMV-së për vitin 2024, Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 151, nga data 25 korrik 2025, linku:

<https://slvesnik.com.mk/Issues/c4e727fbd0545948031345e1868c53b.pdf>

^{viii}Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2025, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 254 nga data 16 dhjetor 2024, linku: <https://www.slvesnik.com.mk/Issues/aa46ac2fcc574dcebca4b70c88dc249e.pdf>

^{ix}Vendimi për rialokimin e fondeve ndërmjet shfrytëzuesve buxhetorë të pushtetit qendror dhe ndërmjet fondeve, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 246 nga data 9 dhjetor 2025, linku:

<https://www.slvesnik.com.mk/Issues/98114c8ba4d5498f99c5f7ea9606021f.pdf>

^xBuxheti i RMV-së për vitin 2026, Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 253, 17 dhjetor 2025, linku:

<https://www.slvesnik.com.mk/Issues/bd5720afda0040d09eaaa43959143bec.pdf>

^{xi}Mendimi i Këshillit Fiskal mbi Rebalancin e Buxhetit për vitin 2025, linku: <https://www.fsovet.mk/wp-content/uploads/2025/06/%D0%9C%D0%B8%D1%81%D0%BB%D0%B5%D1%9A%D0%B5-%D0%BF%D0%BE-%D1%80%D0%B5%D0%B1%D0%B0%D0%BB%D0%B0%D0%BD%D1%81-%D0%BD%D0%B0-%D0%91%D1%83%D1%9F%D0%B5%D1%82.pdf>

^{xii}Konferencë për shtyp e Misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve, 20 tetor 2025, linku:

<https://www.youtube.com/watch?v=V6MKAWEkA4A>

